

VENDIM
Nr. 776, datë 5.9.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin buxhetor 06370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, zëri “Investime”, objekti “TVSH, projekti i kanalizimeve të Tiranës së madhe”, t’i zbritet fondi prej 107 000 000 (njëqind e shtatë milionë) lekësh.

2. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin buxhetor 04520 “Transporti rrugor”, t’i shtohet në zërin “Investime” fondi prej 107 000 000 (njëqind e shtatë milionë) lekësh, për financimin e punimeve të kryera dhe të pafinancuara në objektin “Rikonstrukcion dhe zgjerim i Rrugës së Elbasanit, segmenti Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë - Unaza e Madhe e Tiranës”.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha